



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR SHKODËR

Nr. Rregj. Them. 1262 (61002-02415-51-2016)

Nr. Vendimi 1262 (51-2016 - 4414)

V E N D I M

"Ne Emer te Republikës"

Gjykata e Shkallës së Parë, Rrethi Gjyqësor SHKODËR, e përbërë nga:

Izabela Radovani-Gjyqtare

Asistuar nga sekretarja gjyqësore Erlinda Berati, sot me date 15.10.2016, mori ne shqyrtim ne seance gjyqësore me dyer te hapura çeshtjen administrative penale me nr rregj them. 1262 (61002-02415-51-2016) qe i perket:

KERKUES: Prokuroria e Rrethit Shkoder perfaqesuar nga prokuror Albert Murçaj me autorizim dt.15.10.2016.

OBJEKTI: Leshimin e urdhrit te sekuestrimit te mjeteve monetare.

BAZA LIGJORE: Neni 274, 275 te K.Pr. Penale.

Ne perfundim te gjykimit, organi i Prokurise kerkoj pranimin e kerkeses sipas objektit.
Gjykata pasi shqyrtoi ne teresi çeshtjen

VERËN se

Prokuroria prane Gjyqates se Rrethit Gjyqësor Shkoder I eshte drejtuar Gjyqates me kerkesë per:

- Lëshimin e urdhërit të sekuestrimit të mjeteve monetare të depozituara pranë Bankës Credins në llogarinë e tij, me numer 589518, me gjendje 220, 645.09 (dyqind mije e gjashtëqind e dyzet e pese pike zero nente) USD, në emër të shtetasit ~~Blendi Berati~~, i datelindjes 11.02.1956, mbajtës i dokumentit identifikues kartë identitetit italiane nr. ~~421100000~~
- Lëshimin e urdhërit të sekuestrimit të mjeteve monetare të depozituara pranë Bankës Credins në llogarinë e tij, me numer ~~589518~~, me gjendje llogarije 222.40 Euro në emër të shtetasit ~~Blendi Berati~~, i datelindjes 11.02.1956, mbajtës i dokumentit identifikues kartë identitetit italiane nr. ~~421100000~~
- Lëshimin e urdhërit të sekuestrimit të mjeteve monetare të depozituara pranë Bankës Credins në llogarinë, me numer ~~589518~~, gjendje llogarie 218,321.04 USD, në emër të shtetasës ~~Blendi Berati~~, e datelindjes 26.12.1954, mbajtëse e dokumentit identifikues kartë identiteti italiane nr. ~~421100000~~



- Lëshimin e urdhërimit të sekuestrimit të mjeteve monetare të depozituara pranë Bankës Credins në llogarinë me numer ~~60440~~, gjendje llogarie 222.40 Euro, në emër të shtetases ~~Enxhe Dromogjia~~, e datelindjes 26.12.1954, mbajtese e dokumentit identifikues kartë identiteti italiane nr. ~~9082836~~
- Lëshimin e urdhërimit të sekuestrimit të mjeteve monetare të depozituara pranë Bankës Credins në llogarinë, me numer ~~60450~~, gjendje llogari 219.45 Euro, në emër të shtetases ~~Enxhe Dromogjia~~ ose shtetasit ~~Enxhe Dromogjia~~.

Rezulton se: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkoder ka rregjistruar procedimin penal nr. 1818 dt. 14.10.2016 për veprën penale të "Pastrim të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale" parashikuar nga neni 287 të Kodit Penal.

Nga materialet e ardhura lidhur me këtë çështje ka rezultuar;

Drejtoria e Përgjithshme për Krimin e Organizuar dhe Krimet e Rënda me shikrësë nr.4807-k/4, datë 18.08.2014 dhe nr.4807-k/9, datë 11.12.2014 ka administruar informacione, të dhëna dhe dokumentacion, sipas kritereve të përcaktuara në Ligjin Nr.108, datë 31.07.2014, "Për Policinë e Shtetit", paragrafi 1, germa C, lidhur me veprimtarinë e shtetasit:

1. ~~Enxhe Dromogjia~~, i datelindjes 11.02.1956, mbajtës i dokumentit identifikues kartë identiteti italiane nr. ~~9082836~~, me adresë qendrimi në Shqipëri "Hotel Colosseo", Shkoder. Ka hapur llogari në Bankën Credins në muajin mars 2014.

Po në të njëjtën ditë ka hapur llogari pranë kësaj banke edhe shtetasja italiane ~~Enxhe Dromogjia~~, e datelindjes 26.12.1954, e prezantuar në bankë si bashkejetuese me shtetasin ~~Enxhe Dromogjia~~. Shtetasja italiane ~~Enxhe Dromogjia~~ ka deklaruar se është e punësuar pranë shoqërisë "Madish" shpk dhe se profesioni i saj është teknikë konfesioneshi.

Në periudhën 17.07.2014 - 30.07.2014 (brenda 13 ditëve) shtetasi italian ~~Enxhe Dromogjia~~ ka kryer 4 transfertë nga llogaria e tij personale në Zvicër, dy në favor të llogarisë së tij personale (pranë Bankës Credins) në vlerën totale 230.000 USD dhe dy transfertë në favor të llogarisë personale të shtetases italiane ~~Enxhe Dromogjia~~ (pranë Bankës Credins), me një vlerë totale prej 230.000 USD (totali i transfertave 460.000 USD).

Ata kanë deklaruar se shumatat e transferuara janë kursime të tyre të mbajtura në Zvicër dhe që po shohin mundësinë t'i investojnë në Shqipëri dhe fillimisht mund t'i vendosin si depozita kursimi.

Nga verifikimet e kryera me burime të hapura dhe QKR në emër të ~~Enxhe Dromogjia~~ dhe ~~Enxhe Dromogjia~~ nuk rezultuan transaksione, nuk rezultojnë bizneset në emër të tyre. Nisur nga deklaratat e shtetases italiane ~~Enxhe Dromogjia~~ se është e punësuar në shoqërinë "Madish" shpk, nga verifikimi në QKR dhe të dhënat e burimeve të hapura rezultoi se: Shoqëria "Madish" shpk me NIPIT J667030681 është krijuar në muajin Qershor 1996. Objekti i veprimtarisë është kryesisht "Prodhim i artikujve të brendshme intime për burra dhe gra, pizhameri, korseteri si dhe artikuj të ngjashëm me to. Qepje montim veshje të brendshme dhe uniforme të ndryshme etj." Ortak në themelimin e shoqërisë kanë qenë shtetasit italian ~~Enxhe Dromogjia~~ dhe ~~Enxhe Dromogjia~~.

Në muajin Dhjetor të 2001 ortak i vetëm bëhet ~~Enxhe Dromogjia~~ (duke blerë 100 % të kuotave me vlerë 100.000 Lek) dhe në muajin Maj 2008 ortak i vetëm bëhet ~~Enxhe Dromogjia~~. Në datë 23.02.2010 ~~Enxhe Dromogjia~~ shet 10 % të aksioneve të cilat blihen nga shoqëria "Kimay" srl në vlerën 95.000 EUR. Kapitali i shoqërisë është 87.000.000 Lek. Në emër të shoqërisë "Madish" shpk rezultojnë:

Një numer i konsiderueshëm zhidoganimesh (në vendor mallrash të raportuar 4470 lloje) që prej muajit gushtit 2007 të mallrave kryesisht veshje prej pambuk, copa të prera për qepje, për veshje të ndryshme dhe aksesore ndihmes, kepuce etj.

Në datë 07.08.2012 ~~Enxhe Dromogjia~~ në emër të shoqërisë "Madish" shpk ka lidhur kontratën për blerjen e një sipërfaqe truall prej 192 m² në vlerën 3.360.000 Lek. Pala shitese ~~Enxhe Dromogjia~~.

Në datë 04.03.2014 ~~Enxhe Dromogjia~~ në emër të shoqërisë "Madish" shpk ka lidhur kontratën (kalim të drejtash me kusht) për blerjen e një sipërfaqe truall dhe ndërtesë mbi të në vlerën 8.415.800 Lek. Pala shitese ~~Enxhe Dromogjia~~.

Në datë 20.03.2014 ~~Enxhe Dromogjia~~ në emër të shoqërisë "Madish" shpk ka lidhur kontratën për shitese kredie me Bankën Veneto për shumën 50.000 EUR.

Po në datë 20.03.2014 ~~Enxhe Dromogjia~~ në emër të shoqërisë "Madish" shpk ka lidhur kontratën për marrje kredie me bankën Veneto për shumën 450.000 EUR. Transaksione për likuidim detyrimesh dhe derdhje terheqje në vlera deri në 50.000 EUR.



Nga transaksionet e kryera ne emer te shoqerise "~~ALBISIA~~" shpk nuk rezulton ndonje transaksion i lidhur me shtetasit ~~Enxheta Bensa~~ dhe ~~Vincenzo Gera~~.

Ne lidhje me shtetasin ~~Enxheta Bensa~~, ortak me 90 % ne shoqerine "~~ALBISIA~~" shpk, si dhe nga informacionet qe kemi rezulton se i eshte derguar informacion Njesise se Perbashket Hetimore Tirane, me shikresen nr 2455/56 date 22.06.2010. Ne kete material nder te tjera eshte cilesuar se: ~~Gjergj Bensa~~, i datelindjes 10.08.1959, vendlindja Shkoder, ka kerkuar te kryje nje transferte ne shumen 50,000 Euro, ne France me perfitues kompanine "Scea Tarquin" (ku Z. ~~Bensa~~ eshte aksioner) me qellim: "per arsyen e mbulimit te mungeses se likuiditetit te kompanise per shpenzimet e kryera".

Gjithashtu nga informacione te marra rezulton se Prokuroria Franceze ka filluar procedim penal per kompanine "Scea Tarquin", si subjekt i nenit 324 te Kodit Penal Francez, per vepren penale te pastrimit te parave.

Nga burime te hapura ne lidhje me shoqerine "Kimay srl" (ortakë me 10 % ne "~~ALBISIA~~" shpk) rezulton se eshte themeluar ne vitin 1989 si nje kompani tregtare e produkteve ushtarake, adresa Bergamo. Qe nga viti 1997, pas 4 vjet prodhimi dhe bashkepunimi me kompani te tjera kryesore ne fushen e balistike, ka krijuar xhaketë antiplumb, duke u bere ne 5 vjet prodhuesi i pare ne tregun civil ne Itali. Ne vitin 2008, ka hyre ne nje partneritet me "~~Vittek~~" shpk, Shkoder, ne Shqipëri.

Ne lidhje me ~~Enxheta Bensa~~ rezulton se banon ne Bergamo.

Nga informacioni I administruar nga Drejtoria per Krimin Ekonomik e Financiar per shtetasit:

- ~~Enxheta Bensa~~, i datelindjes 11.02.1956, mbajtes i dokumentit identifikues karte identitetit italiane nr. ~~47200028~~.
- ~~Vincenzo Gera~~ e datelindjes 26.12.1954, mbajtese e dokumentit identifikues karte identiteti italiane nr. ~~47181631~~.

Ne perqijaje te shikreses tone Nr 4807/K/3 Prot e dates 18.08.2014, drejtuar Ambasadës Italiane, Zyres Nderlidhese Italiane Interforce me shikresen Nr UCI/ALB/RF137/4/FS e dates 03.12.2014, informohemi se nga nje verifikim i kryer prane arkivit te te dhenave SDI rezulton :

- ~~Enxheta Bensa~~ lindur ne Lee (CO) me 11.02.1956 fizikisht banues ne Casanova Lerrone (SV) in Fraz. Vellego N.80. figuron ne vitin 2010 i denoncuar prane autoritetit Gjyqesor per dhunim banese.
- ~~Vincenzo Gera~~ lindur ne San Giovanni (AG) me date 26.12.1954, fizikisht banuese ne Sarnico (BG) ne rrugen Sora n.l, titullare e vetme e shoqerise me te njejtin emer dhe me NIPT ~~0973351768~~ me seli fiskale ne adresen e lartepmendur ne Sarnico, si dhe aktive ne "sherbime te tjera". Kjo shtetase rezulton qe ne vitet 1993 dhe 1998 eshte denuar perkatesisht me gjobe per shkelje te normatIVES mbi parandalimin e fatkeqesive ne pune si dhe me dy muaj burg dhe me pas me anulim denimi per falsifikim te kryer privatisht ne akte publike. Ne vitin 2010 eshte denoncuar prane Autoriteteve Gjyqesore per veprat penale kunder administrates publike.

Nga organi Prokurorise jane administruar edhe keto informacione :

1. Zyres Vendore te Regjistrimit te Pasurive te Paluajtslime Shkoder per shtetasit ~~Enxheta Bensa~~, dhe ~~Vincenzo Gera~~ dhe nga ana e ketij Institucioni eshte kthyer perqijaje se shtetasit e lartepmendur nuk kane te regjistruar pasuri te paluajtslime.
 2. Drejtorise Rajonale Tatimore Shkoder per shtetasit ~~Enxheta Bensa~~ dhe ~~Vincenzo Gera~~ dhe nga ana e ketij Institucioni eshte kthyer perqijaje se shtetasit e lartepmendur nuk jane te rregjistruar pe ushtrim aktiviteti privat.
 3. Drejtorise Rajonale Aluiznit Shkoder per shtetasit ~~Enxheta Bensa~~ dhe ~~Vincenzo Gera~~ dhe nga ana e ketij Institucioni eshte kthyer perqijaje se shtetasit e lartepmendur nuk rezultojne aplikues per legalizim objekti.
 4. Drejtorise Rajonale te Sherbimit Transportit Rrugor Shkoder per shtetasit ~~Enxheta Bensa~~ dhe ~~Vincenzo Gera~~ dhe nga ana e ketij Institucioni eshte kthyer perqijaje se shtetasit e lartepmendur nuk kane mjete te regjistruara. Duke qene se mjetet monetare te qarkulluara nga ~~Enxheta Bensa~~ dhe nga shtetesja ~~Vincenzo Gera~~ ne llogaritë bankare te tyre, dyshohet te kene burim te paligjshem apo prejardhje nga vepra penale si dhe duke patur parasysh se ato mund te jene objekt i konfiskimit sipas nenit 36 të Kodit Penal, në mbështetje te neneve 274, 275 te K. Pr Penale, organi prokurorise kerkoi pranimin e kerkeses.
- Neni 274- Objekti i sekuestros preventive
(Ndryshuar pika 2 me ligjin nr.9085, datë 19.6.2003)



1. Kur ka rrezik që disponimi i lirë i një sendi që lidhet me veprën penale mund të rëndojë ose të zgjasë pasojat e saj ose të lehtësojë kryerjen e veprave penale të tjera, me kërkesën e prokurorit, gjykata kompetente urdhëron sekuestrimin e tij me vendim të arsyetuar.

2. Sekuestruoja mund të vendoset edhe për sendet, produktet e veprës penale dhe çdo lloj pasurie tjetër që lejohet të konfiskohet, sipas nenit 36 të Kodit Penal.

3. Kur ndryshojnë kushtet e zbatimit, gjykata, me kërkesën e prokurorit ose të të interesuarit, e heq sekuestron.

Neni 275

Humbja e fuqisë së sekuestruos

1. Me vendimin e pafajësisë ose të pushimit të çështjes, gjykata ose prokurori urdhëron që sendet e sekuestruara t'i kthehen atij që i takojnë, kur nuk duhet të urdhërojnë konfiskimin e tyre sepse kanë shërbyer ose ishin të destinuara për të kryer një veprë penale ose sepse kanë qenë prodhim ose përfitim nga vepra penale.

2. Kur është dhënë vendimi i dënimit, efektet e sekuestruos vazhdojnë në rast se është vendosur konfiskimi i sendeve të sekuestruara.

3. Sendet e sekuestruara nuk kthehen kur gjykata vendos që të mbahet sekuestruoja për garantimin e kredive.

Gjykata pasi shqyrtoi në teresi çështjen arriti në konkluzionin se kërkesa është e drejte dhe e bazuar si në ligj dhe në prova dhe si e tillë duhet pranuar.

Në rastin duke qenë se për mjeteve monetare të qarkulluara nga ~~Banka e Italisë~~ dhe nga shitësitja ~~Banka e Italisë~~ në llogaritë bankare të tyre, ka dyshime të arsyeshme të kenë burim të paligjshëm apo prejardhje nga vepra penale si dhe duke patur parasysh se ato mund të jenë objekt i konfiskimit sipas nenit 36 të Kodit Penal, në mbështetje të neneve 274, 275 të K. Pr. Penale, cmon në pranimin e kërkeses.

PER KETO ARSYE

Gjykata bazuar në nenin 274, 275 223/3 të K. Pr. Penale

VENDOSI

- Pranimin e kërkeses.
- Urdhërohet sekuestrimi i mjeteve monetare të depozituara pranë Bankës Credins në llogarinë e tij, me numer ~~123456~~, me gjendje 220, 645.09 (dyqind mijë e gjashtëqind e dyzet e pesë pike zero nente) USD, në emër të shtetasit ~~Ilir Durrës~~, i datelindjes 11.02.1956, mbajtes i dokumentit identifikues kartë identitetit italiane nr. ~~123456789~~.
- Urdhërohet sekuestrimi i mjeteve monetare të depozituara pranë Bankës Credins në llogarinë e tij, me numer ~~123456~~, me gjendje llogarije 222.40 Euro në emër të shtetasit ~~Ilir Durrës~~, i datelindjes 11.02.1956, mbajtes i dokumentit identifikues kartë identitetit italiane nr. ~~123456789~~.
- Urdhërohet sekuestrimi i mjeteve monetare të depozituara pranë Bankës Credins në llogarinë, me numer ~~123456~~, gjendje llogarije 218,321.04 USD, në emër të shtetasit ~~Ilir Durrës~~, e datelindjes 26.12.1954, mbajtes e dokumentit identifikues kartë identiteti italiane nr. ~~123456789~~.
- Urdhërohet sekuestrimi i mjeteve monetare të depozituara pranë Bankës Credins në llogarinë, me numer ~~123456~~, gjendje llogarije 222.40 Euro, në emër të shtetasit ~~Ilir Durrës~~, e datelindjes 26.12.1954, mbajtes e dokumentit identifikues kartë identiteti italiane nr. ~~123456789~~.
- Urdhërohet sekuestrimi i mjeteve monetare të depozituara pranë Bankës Credins në llogarinë, me numer ~~123456~~, gjendje llogari 219.45 Euro, në emër të shtetasit ~~Ilir Durrës~~ ose shtetasit ~~Ilir Durrës~~.
- Për kryerjen e këtyre veprimeve ngarkohen Prokuroria Rrethit Shkoder dhe Policia gjyqesore e Drejtorisë Qarkut Shkoder.
- Kunder këtij vendimi mund të behet ankim nga personat e interesuar brenda 10 diteve nga marrja dijeni.

U shpall sot me daten 15.10.2016 ora 11.00

Gjyqtare

Izabela Radovani

